

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT,
PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Nr. _____ Prot.

Data ____ / ____ / 2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)



ose

OE “Griald” shpk ■

OE “Griald” shpk me NIPT J68117216C me adresë Lagjja e Re, Rruga Uzines, Zona Kadas Nr.2315,
Nr. Pasurie 51/62, Kukes

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ■

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO ■

Nëse po, të jepen dhënat: _____

Tipi i Kontratës: **PUNË**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E Hapur**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-95174-08-03-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i rrjetit TM, kabinave dhe rrjetit TU te fiderit Aranitas dhe rikonfigurimi i linjave TM nga Pika e Shperndarjes Ballsh, ne N/St. TEC 110/35/6 kV”, me afat zbatimi 6 muaj.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **04.08.2026**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Nr 51 datë 10.08.2026**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

– **oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim** ■

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- **BOE "Caushi M" shpk & "K.M.K" shpk, me perfaqësues "K.M.K" shpk:**

- "K.M.K" shpk me NIPT L78223801E me adrese Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090 Mallakaster 1057
- "Caushi M" shpk me NIPT L88419801O me adrese Ballsh-Mallakaster, Bulevardi Rrapo Hekali, Shkalla 1, Kati 1, Z.Kadastrale 1090 Mallakaster 1057

Vlera **132.214.049** ((njëqind e tridhjetë e dy milion e dyqind e katërmbedhjetë mijë e dyzet e nente) lekë
OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

- **OE "Griald" shpk:**

- OE "Griald" shpk me NIPT J68117216C me adresë Lagjja e Re, Rruga Uzines, Zona Kadas Nr.2315, Nr. Pasurie 51/62, Kukes

Vlera **135,615,989** (Njëqind e tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e nente) leke

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

- **"PE-VLA-KU" shpk:**

- OE "PE-VLA-KU" shpk me NIPT K61716013M me adresë Rruga Muzaket, Pallatet Vokshi, K. 7, 1001 Tirane

Vlera **139,492,171.74** (njëqind e tridhjetë e nëntë million e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e katër lekë) lekë

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

BOE "Caushi M" shpk & "K.M.K" shpk, me perfaqësues "K.M.K" shpk

1. Referuar pikes 2.Kriteret e veçanta të kualifikimit b.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Në zbatim të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", kreu xi, kushte të përgjithshme për zbatim, Neni 88 Bashkimi i operatorëve ekonomikë pika 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

Sigurimi i ofertës i paraqitur për plotësimin e kësaj kërkesë nuk ka të specifikuar pjesëmarrjen në Bashkim të operatorëve ekonomikë.

2. **Per plotësimin e kërkesës** 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

1. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë. Për kontrata të realizuara me ente publike, Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim

2. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **të deklaruara në organet tatimore** dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të nenit 88 pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar Pika 2.3.1 gërma "a" plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Ndërsa pika 2.3.1 gërma "b" duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar)

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Nga analizimi i të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga BOE K.M.K shpk dhe Caushi M Shpk rezulton se nuk plotësohen vlerat e kërkuara për punë të ngjashme për një objekt të vetëm gjithashtu për disa punë të ngjashme sipas gërmave a dhe b nga të dy pjesëmarrësit në BOE.

3. **Për të përmbushur pikën 2.3.4 të DST kërkohet që:** Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve si më poshtë:

Shtylla b.a.c centrifugale, Ndaresa, shkarkues, siguresa TM, Tranformator Fuqie, Panele TU, Kabllot TM 20 Kv, Cela TM 20 Kv, Tel Al-C, Kabllo TU, Kabllo ABC, Aksesori për linjat ABC

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë:

a. Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

b. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Pasi u shqyrtua dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e kësaj kërkesë rezulton se përveç artikullit shtylla për të gjithë artikujt e tjerë është paraqitur dokumentacion në gjuhë të huaj në kundërshtim me kërkesën e mësipërme dhe gjithashtu në kundërshtim me pikën 4.7 të njoftimit të kontratës në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE "Griald" shpk me adresë Lagjia e Re, Rrugë Uzinë, Zona Kadas Nr.2315, Nr. Pasurie 51/62, Kukes, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **135,615,989** (Njëqind e tridhjetë e pesë milion e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e nente) leke / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

**DREJTOR I DREJTORISË RAJONALE FIER
OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A**

Ing. Bledar GJUZI